MIRATOHET

MINISTRI NDËRTIMIT

ISMAIL AHMETI

# KËRKESË
## PËR KRIJIMIN E SHOQATËS SHKENCORE TË GJEODETËVE TË SHQIPËRISË.

Në bazë të nenit 8 të ligjit Nr.2367, datë 6.11.1956: " Për organizatat shoqërore që nuk ndjekin qëllime ekonomike" paraqitim kërkesën tonë për dhënien e pëlqimit prej Ministrisë së për krijim të Shoqatës Gjeodetëve të Shqipërisë.

Kjo shoqatë do të ndikojë në rritjen e vazhdueshme të nivelit të gjeodetëve në vendin tonë, në rritjen e aftësive ideoprofesionale të kuadrove për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit gjeodezik. Për ruajtjen e figurës morale të punonjësve të kësaj shoqate sipas kërkesave të etikës dhe moralit të shoqërisë sonë shqiptare.

Bashkë me kerkesën tonë për dhënien e pëlqimit për krijimin e kësaj shoqate po i'u paraqesim dhe projekt-statutin e saj që është nënshkruar nga themeluesit e vet.

1. Muharrem Dragovoja
2. Zenel Hoxha
3. Veiz Ostrovica
4. Qemal Skuka
5. Gëzim Hajdari
6. Gëzim Hasko
7. Gëzim Gjeta
8. Pal Nikolla
9. Gjergj Qoleshi
10. Zef Lleshi
11. Hiqmet Shehu
12. Arben Xhiholli
13. Ali Lleshi
14. Marko Zendeli
15. Miranda Zeka

"Shpallja"

M I R A T O H E T

MINISTRI NDËRTIMIT

ISMAIL AHMETI

## STATUTI I SHOQATËS SË GJEODETËVE TË SHQIPËRISË

### I. Krijimi dhe detyrat e shoqatës

#### Neni 1

Shoqata është një organizatë shkencore e krijuar nga bashkimi vullnetar i gjeodetëve, fotogrametristëve dhe hartografëve shqiptarë.

Qëllimi i saj do të jetë trajtimi i problemeve shkencore dhe organizative të së tashmes dhe së ardhmes të shërbimeve gjeodezike të vendit të para këto të lidhura ngushtë me interesat ekonomike dhe të mbrojtjes së vendit.

#### Neni 2

Mbikqyrja dhe kontrolli i veprimtarisë të kësaj shoqate do të ushtrohet nga Ministria e Ndërtimit.

#### Neni 3

Shoqata jep ndihmesë në zhvillimin e Gjeodezisë, Fotogrametrisë dhe Hartografisë nëpërmjet debatit të gjërë shkencor për problemet e ndryshme. Popullarizon arritjet shkencore dhe përvojën e përparuar në shkallë kombëtare e ndërkombëtare.

#### Neni 4

Shoqata bashkërendon aktivitetin e saj shkencor në shërbimin gjeodezik të ndërmarrjeve, në institutet kërkimore e shkencore, me Universitetin e Tiranës "~~Enver Hoxha~~" dhe me Akademinë e Shkencave të RPSSH. Ajo lidhet gjithashtu me shoqata homologe në vende të tjera dhe ato ndërkombëtare.

### Neni 5

Shoqata do të interesohet energjikisht për ecurinë e studimeve e përgjithësimeve shkencore, do të nxitë anëtarët e saj për të marrë pjesë në këto studime dhe do të përdorë stimujt materialë dhe moralë për ata punonjës që dallohen në punën shkencore (praktike dhe teorike)

### Neni 6

Shoqata do të organizojë konsulta, sesione, konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare.

Për veprimtarinë e saj shoqata ka të drejtë të nxjerrë botime të veçanta, të ketë bibliotekën e saj dhe muzeun e saj.

### Neni 7

Shoqata e Gjeodetëve të RPSSH është person juridik. Qëndra e saj është në Tiranë. Ajo ushtron veprimtarinë e saj në gjithë teritorin e RPSSH.

## 2. Kushtet për hyrjen dhe daljen e anëtarëve në Shoqatë

Anëtar të kësaj shoqate kanë të drejtë të jenë:

a) Specialistë të lartë dhe studentë të degëve Gjeodezi, Fotogrametri, Hartografi, Astronomi, Hidrografi.

b) Specialistë të mesëm që janë shquar në punimet praktike Gjeodezike.

c) Specialistë të fushave të tjera të përafërta me to.

Anëtarët e shoqatës kanë të drejta të barabarta. Numuri i tyre është i pakufizuar.

Pranimi i anëtarit të shoqatës bëhet me kërkesën e tij, me shkrim, drejtuar Këshillit të Shoqatës.

Në shoqatë pranohen dhe shkencëtarë të shquar të vendeve të huaja. Anëtarët pajisen me librezën e anëtarësisë.

Neni 9

Çdo anëtar paguan një kuotizacion anëtarsie vjetore prej 24 lekësh. Anëtarët rekomandohet të abonohen në (buletinin) e shoqatës. Anëtarët e huaj nuk paguajnë kuotizacion dhe e përfitojnë buletinin falas.

Neni 10

E drejta e anëtarësisë humbet:

a) Kur anëtari e kërkon largimin nga shoqata me dëshirën e tij.

b) Kur shkel statutin e shoqatës.

c) Për veprimtari që bien në kundërshtim me interesat e shtetit tonë.

d) Kur nuk paguan kuotizacionin.

Neni 11

Organi më i lartë i shoqatës është Asambleja e Shoqatës e cil përbëhet nga përfaqësues të degëve në qëndër dhe në rrethe ose nga mble dhja e përgjithshme e saj.

Neni 12

Midis mbledhjeve të asamblesë, shoqata drejtohet nga Këshilli i Shoqatës i cili është zgjedhur nga Asambleja e përgjithshme me vote të hapura çdo 2 vjet.

Këshilli përbëhet nga 15 anëtarë, ai zgjedh kryesinë e tij prej 5 vetash: Kryetar, N/kryetar, Sekretar dhe dy anëtarë.

Neni 13

Këshilli i Shoqatës mblidhet çdo 3 muaj, ndërsa Asamblja e shoqatës sipas problemave 1-2 herë në vit. Seanca e fundit vjetore ka karakter të Asamblesë së Përgjithshme për zgjedhjet ose ndryshimet eventuale.

Neni 14

Statuti dhe ndryshimet e pjesshme miratohen në mbledhjen plenare të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqatës.

Neni 15

Shoqata e zhvillon veprimtarinë e saj në rrethe me anë të degëve të Shoqatës. Ato drejtohen nga një kryesi e përbërë nga kryetar n/kryetar e sekretar që zgjidhen çdo 2 vjet nga mbledhje e anëtarëve të degës së shoqatës.

- Numuri i anëtarëve në një degë të shoqatës të jetë jo më pak se 5 veta.

Neni 16

Këshilli i Shoqatës funksionon sipas një rregulloreje të brendshme të miratuarnga ai vet, sipas programit të kryesisë.

Neni 17

Burim të ardhuresh për fondin e shoqatës do të jenë

a- Kuotizacionet

b- Të ndryshme

Neni 18

Ky statut u votua dhe u miratua në mbledhjen e parë të Asamblesë të Përgjithshme të Shoqatës të mbajtur më datë ..20/II/1991..